



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT PËR MBROJTJEN SOCIALE

DREJTORIA E POLITIKAVE TË PËRKUJDËSËS SOCIALE DHE SHËRBIMEVE SOCIALE TË INTEGRUARA

Nr. 2327 Prot

Tiranë, më 17.05.2024

UDHËZIM

Nr. 281, datë 17.05.2024

“PËR MIRATIMIN E KORNIZËS SË STANDARDEVE BAZË TË CILËSISË PËR SHËRBIMET E KUJDESIT SOCIAL”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3 të nenit 27 dhe 51 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

- Miratimin e “Kornizës së Standardeve Bazë të Cilësisë për Shërbimet e Kujdesit Social”, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
- Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
- Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, apo dhe/ose personave juridik publik/privat, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.
- Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror siguron realizimin e procesit të akreditimit të shërbimeve sociale, publike dhe jo-publike, bazuar në standartet dhe protokollet e zbatimit të tyre, nëpërmjet vlerësimit të cilësisë të ofrimit të shërbimeve të kujdesit social.
- Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati Përgjegjës për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.



Adresa: "Rruga e Kavajës", Tirana, Albania. Tel: +355 42944622 | shendetesia.gov.al

**Korniza për
Standardet Bazë të
Cilësisë
për
Shërbimet e Kujdesit
Social**

Përbledhje e pikave kryesore

Në kontekstin e reformës për mbrojtjen sociale, lidhur me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, si dhe duke pasur parasysh perspektivën e anëtarësimit të mundshëm të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e ka përcaktuar si prioritet përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social dhe standardeve që i rregullojnë këto shërbime. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sa i përket zbatimit të Shtyllës Evropiane të së Drejtave Sociale.

Korniza përshkruan një paketë me **10 standarde bazë cilësie** dhe **28 kritere të lidhura me to** që synojnë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social.

Qëllimi i këtyre standardeve dhe kritereve të rishikuara është i dyfishtë. Së pari, krijimi i një sistemi standardesh, kriteresh dhe treguesish uniformë, të harmonizuar, që do të ndihmojnë përritjen e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social. Për sa i përket kësaj, Korniza skicon dhe lidhjen midis standardeve bazë të cilësisë dhe sistemit të sigurimit të cilësisë së shërbimeve të kujdesit social në Shqipëri.

Së dyti, Korniza rrit kalibrin e standardeve në përputhje me praktikat evropiane, gjë që Korniza e kryen nëpërmjet përafrimit të saj me Kornizën Vullnetare Evropiane të Cilësisë për Shërbimet Shoqërore (KECShSh), që përshkruan dhe parimet thelbësore të cilësisë që kanë ndihmuar përcaktimin e standardeve, kritereve dhe treguesve; por edhe me kuadrin rregulator aktual për shërbimet e ndryshme të kujdesit social të ofruara në Shqipëri për të siguruar rëndësinë e tyre në nivel kombëtar.

Korniza përshkruan edhe metodologjinë për zbatimin e këtyre standardeve bazë të rishikuara të cilësisë, që do të përfshijë zhvillimin e treguesve për 5 kategori të ndryshme shërbimesh të kujdesit social dhe do të sjellë si rezultat një format model për secilin prej standardeve, kritereve dhe treguesve. Kjo do të bëhet paralelisht me zhvillimin e 5 manualeve për të lehtësuar zbatimin hap-pas-hapi të shërbimit në harmoni me standardin.

Nëpërmjet propozimit të një qasjeje konkrete metodologjike për rishikimin e standardeve, ky dokument do t'i ndihmojë ofruesit e shërbimeve të kujdesit social, si dhe autoritetet publike të ngarkuara me organizimin dhe financimin e shërbimeve të kujdesit social, të zhvillojnë në nivelin e duhur mjete specifike për matjen dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social. Në këtë mënyrë, do të shërbejë si referencë përcaktimin, sigurimin, vlerësimin, akreditimin dhe procesin e licensimit së këtyre shërbimeve. Standardet e rishikuara, kriteret dhe treguesit do të promovojnë dhe një qasje të integruar ndaj ofrimit të shërbimeve të kujdesit social, së bashku me llojet e tjera të shërbimeve, si shërbimet arsimore, shëndetësore dhe të punësimit.

Duhet vënë në dukje se zhvillimi i standardeve është një proces i vazhdueshëm dhe rishikimi i mëtejshëm i tyre, bazuar te përvoja e grumbulluar, mund të parashikohet pas një periudhe 5-7 vjeçare. Një përditësim i tillë bëhet më i lehtë nga krijimi i grupeve këshilluese ndësektoriale

që e kanë mbështetur zhvillimin e Kornizës, duke përfshirë administratrat publike, ofruesit e shërbimeve, përfaqësuesit e grupeve të përdoruesve të shërbimit dhe të tjera.

I. Konteksti konceptual i Kornizës

Përkufizimi i shërbimeve të kujdesit social

Shërbimet e kujdesit social në Shqipëri

Ligi për Shërbimet e Kujdesit Social i vitit 2016 i përcakton shërbimet e kujdesit social si "sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror."

Shërbimet sociale në kontekstin e Bashkimit Evropian

Në kuadrin ligjor dhe rregullator të BE-së nuk ka një përkufizim të përgjithshëm të shërbimeve sociale. Megjithatë, një komunikim nga Komisioni Evropian (KE) në 2006¹ si dhe Korniza Evropiane e Cilësisë për Shërbimet Shoqërore (KECShSh) ofrojnë një bazë për perspektivën evropiane. Në KECShSh, termi shërbim social u referohet "(...) në veçanti shërbimeve *thelbësore që i ofrohen drejtpërdrejt personit. Shumë shpesh, autoritetet publike në Shtetet Anëtare i konsiderojnë këto shërbime, që janë të përfshira në sistemet e mirëqenies sociale të Shteteve Anëtare, si shërbime që kanë interes të përgjithshëm dhe u nënshtrohen kërkesave specifike të shërbimit publik. Shembuj shërbimesh sociale janë shërbimet e asistencës sociale, kujdesi afatgjatë, kujdesi përfshirja sociale, niveli i lartë i punësimit dhe trajnimit, asistentët personalë dhe strehimi social."*"

Megjithëse qëllimi dhe mënyra e organizimit të shërbimeve sociale ndryshojnë ndjeshëm sipas specifikave historike, gjeografike, sociale dhe kulturore, këto shërbime sociale janë thelbësore për përmbrushjen e objektivave bazë të BE-së, si arritja e kohezionit social, ekonomik dhe territorial, përfshirja sociale, niveli i lartë i punësimit dhe rritja ekonomike.

Shërbime cilësore kujdesi social

E drejta për të aksesuar shërbime sociale cilësore është e sankzionuar me parimet 11, 17, 18 dhe 19 të Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale. Përkufizimi i cilësisë këtu mund të shihet si "*dorëzimi i duhur i një shërbimi ose produkti të rënë dakord reciprokisht*"². Bashkimi Evropian bën thirrje dhe për shërbime cilësore kujdesi social nëpërmjet strategjive të ndryshme specifike,

¹ Komunikimi nga Komisioni - Zbatimi i programit të Komunitetit të Lisbonës - Shërbimet sociale me interes të përgjithshëm në Bashkimin Evropian {SEC(2006) 516} /* COM/2006/0177 final */

² Grupi i Punës i Rrjetit Social Evropian për Cilësinë e Shërbimeve Sociale, Rritja e Cilësisë në Shërbimet Sociale, Përbledhje Ekzekutive, 2022

si Strategjia Evropiane e Kujdesit dhe Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030.

Në përputhje me KECSHSh-në, burimi i përcaktimit të kësaj cilësie mbështetet te parimet e cilësisë që “*shprehin vlera të përbashkëta dhe synojnë të zhvillojnë një të kuptuar të përbashkët të cilësisë së shërbimeve sociale, si dhe të lehtësojnë shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira*”. Për më tepër, ato ”*u drejtohen autoritetet e publike përgjegjëse, shpesh në nivel rajonal ose lokal, për zhvillimin, organizimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale...[dhe] u drejtohen dhe ofruesve të shërbimeve për aq sa kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve sociale, si dhe përdoruesve, për të cilët përfaqësojnë një burim të rëndësishëm informacioni për cilësinë e shërbimeve sociale që ata mund të presin.*” Përveç kësaj, KECSHSh-ja thekson dhe se ”*këto parime janë drejtpërdrejt të rëndësishme edhe për punonjës dhe punëdhënës të sektorit*” (shih Shtojcën 3 për një përbledhje parimesh të cilësisë për shërbimet sociale siç përshkruhet nga KECSHSh-ja).

Këto parime cilësie duhet të përkthehen në **standarde, kriteret treguese të matshëm për shërbimet e kujdesit social, që të sigurohet plotësimi i tyre**. Standardet quhen **standarde bazë të cilësisë (SBC)**, që garantojnë cilësinë e një shërbimi të kujdesit social nëpërmjet të qenit detyrim ligjor për palët e përfshira në financimin, sigurimin, inspektimin dhe vlerësimin e tyre.

Standardet bazë të cilësisë (SBC)	Deklaratë e një niveli të përcaktuar cilësie gjatë ofrimit të shërbimeve që kërkohet për të përbushur nevojat e përdoruesve të synuar të shërbimit. Nga pikëpamja ligjore, përdoruesi i shërbimit ka të drejtë të marrë një shërbim që plotëson standardet bazë, dhe për këtë arsyе standardet bazë janë të detyrueshme ligjërisht.
--	---

Një standard minimal cilësie përcakton pritshmëritë e performancës, strukturat ose proceset që i nevojiten një ofruesi shërbimi për të ofruar shërbimin e kujdesit social në përputhje me parimet e përgjithshme të cilësisë. Ato janë një grup kriteresh dhe treguesish të matshëm dhe të verifikueshëm që duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret e ndryshme ekzistuese.


Në kohën e shkrimit të këtij materiali, në Shqipëri, SBC-të ekzistojnë për 25 shërbime kujdesi social që duhet të kuptohen si standarde bazë që përshkruajnë një nivel cilësie të detyrueshëm. Megjithatë, siç u përmend më lart, ato ndryshojnë shumë për sa i përket strukturës, përbajtjes dhe objektivave të tyre.

Standardet vullnetare janë kërkesa që shkojnë përtej SBC-ve, që mund të zbatohen nga ofruesi i shërbimit të kujdesit social, bashkia ose palë të tjera për të ndjekur zbatimin e një shërbimi të

kujdesit social - p.sh. në lidhje me certifikatat ISO, shoqatat profesionale, kodin e etikës së donatorëve të ndryshëm etj.

Standardet si pjesë e një sistemi sigurimi të cilësisë

Qëllimi i sistemit të sigurimit të cilësisë për shërbimet e kujdesit social është krijimi dhe ruajtja e cilësisë së ofrimit të shërbimit të kujdesit social në përputhje me vlerat, qëllimet dhe objektivat e shërbimit të kujdesit social – të shprehura nëpërmjet SBC-ve në fuqi – duke përfshirë, por pa u kufizuar prej saj - zbatueshmërinë ligjore të dispozitës, të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Standardet bazë përcaktojnë edhe pragun e zbatueshmërisë ligjore dhe janë të detyrueshme për sa i përket këtij aspekti.



Përbërësit e sistemit të sigurimit të cilësisë në Shqipëri


Korniza i përkufizon përbërësit e mësipërm sa më poshtë:

- | | |
|------------------|---|
| inspektim | proces që garanton përputhshmërinë me ligjin gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit social, nëpërmjet SBC-ve |
| monitorim | mbështetje për përbushjen e qëllimeve dhe objektivave të një shërbimi të kujdesit social, përrritjen e SBC-ve |
| akreditim | siguron përbushjen e kërkësave për një ofrues shërbimesh të kujdesit social (p.sh., numri dhe kualifikimi i personelit, statusi ligjor dhe gjendja financiare, që çojnë, ose në lëshimin (zgjatjen) e akreditimit, ose përkatesisht në moslëshim ose përfundim. |

<i>licensim</i>	vlerësim i nivelit të kualifikimit profesional dhe rikualifikim i një eksperti siç kërkonet nga ligjet në fuqi, që çon ose në rinovimin e licencës profesionale, ose në përfundimin e saj.
<i>zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZhVP)</i>	kërkon që eksperti i licencuar t'i nënshtronhet rikualifikimit të rregullt në përputhje me rregulloret në fuqi (përfshirë SBC-të); mosrespektimi i këtyre kërkesave çon në përfundimin e licencës profesionale;
<i>Kostim, buxhetim dhe financim</i>	Kostimi për njësi, buxhetimi dhe financimi i shërbimeve të kujdesit social, që është i lidhur me SBC-të

Rëndësia e standardeve

Në kontekstin e shërbimeve të kujdesit social, përshtatshmëria e shërbimit të ofruar - me performancën bazë të shprehur në standardin minimal përkatës - është e rëndësishme për një dialog mes grupeve kryesore të interesit në kujdesin social: përdoruesve të shërbimit, ofruesve të shërbimit dhe administratës publike.



Rëndësia e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social

Të tria palët kanë interes jetik që shërbimet e kujdesit social të aplikohen në mënyrë efikase dhe të ligjshme, dhe rrjedhimisht që të zhvillohen SBC-të.

Ndërkohë që ofruesit dhe administratat publike janë njëkohësisht të varur dhe përgjegjës për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në përputhje me SBC-të, SBC-të i mbrojnë përdoruesit

e shërbimeve nga praktikat e paligjshme dhe/ose praktikat joprofesionale që mund të ndikojnë drejtpërdrejt negativisht mirëqenien e përdoruesit të shërbimit.

Prandaj, në nivel politikash, këto tri palë duhet të bien dakord për proceset, duke përfshirë standarde, treguesit dhe rezultatet që sigurojnë cilësinë e shërbimeve. Kjo është arsyja pse Korniza është mbështetur te puna e GP-së, si dhe te konsultimi i grupeve të interesit gjatë zhvillimit të saj.

Standardet, kriteret dhe treguesit

Për matjen e nivelit të zbatimit të standardeve përdoren kritere dhe tregues. Kriteret dhe treguesit duhet të pasqyrojnë funksionueshmérinë e standardeve dhe në mënyrë indirekte, parimet e cilësisë së KECShSh-së siç përshkruhen në Aneksin 3. Standardet kthehen në një deklaratë të paqartë qëllimi kur kriteret dhe treguesit nuk zhvillohen dhe nuk garantojnë sukses për ofrimin e shërbimit.

Standard përcakton se çfarë pritet në lidhje me shërbimin e ofruar për përdoruesit e shërbimit.

Kritere përcaktojnë një karakteristikë shërbimi që duhet të jetë zbatuar (e lidhur me inputin) ose një karakteristikë aplikimi (e lidhur me procesin) në mënyrë që të arrihet standardi i përcaktuar. Për këtë arsy, kriteret shprehen si rezultate. Ato i japin kuptim dhe funksionueshméri një standardi pa qenë vetë një njësi matëse e drejtpërdrejtë e standardit.

Tregues është një konkretizim ose funksionueshméri e prekshme e kritereve dhe ndihmon për matjen e përbushjes së kritereve. Treguesit shprehen në mënyrë sasiore ose cilësore.

Në kuadrin e shërbimeve të kujdesit social, kriteret dhe treguesit shpesh janë në format dokumentesh ligjore, konventash ndërkombëtare, standardesh profesionale, kodesh sjelljeje, etj.

Pjesa II e Kornizës thekson standardet, kriteret dhe treguesit që do të aplikohen për të gjitha shërbimet e kujdesit social.

Inspektimi dhe monitorimi

Siç u vu në dukje më sipër, inspektimi dhe monitorimi kanë dy role të dallueshme në lidhje me SBC-të.

Monitorimi përfshin vlerësimin e ofrimit të shërbimit kundrejt arritjeve të qëllimeve dhe objektivave, dhe krijon mundësi përmarrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm dhe të përhershëm të ofrimit të shërbimit (të tilla si praktikimi i shembujve të mirë, trajnimi dhe përmirësimi i sjelljes profesionale, përfshirja e hulumtimit shkencor, etj.)

Inspektimi ka të bëjë me një vlerësim të dispozitave në krahasim me rregulloren ligjore dhe garanton përputhjen ligjore të ofrimit të shërbimit. Ai bazohet te kuadri ligjor, aktet nënligjore dhe angazhime të tjera ligjërisht të detyrueshme.

Kriteret dhe treguesit për SBC-të identifikojnë ligjet dhe aktet nënligjore të zbatueshme që kerkohen për të dyja proceset, por me dy rezultate të ndryshme: njëri trajton proceset e përmirësimt të cilësisë (monitorimi), dhe tjetri trajton pajtueshmërinë ligjore (inspektimi).

Shpjegimi i kuadrit ligjor për zbatimin e shërbimeve të kujdesit social bëhet në manuale dhe do të zhvillohet në vazhdimesi.

Arritja e standardeve

SBC-të që janë zhvilluar dhe shfaqen në Pjesën II të Kornizës pasqyrojnë një kalibër më të lartë standardesh dhe kriteresh dhe përfaqësojnë një risi në sistemin e shërbimeve të kujdesit social në Shqipëri. Kur cilësia e shërbimit është në përputhje me standardet, kjo në përgjithësi do të thotë se standardet reflektojnë kushtet aktuale. Në rastet kur cilësia e shërbimit të ofruar vazhdon të jetë nën standard, këto standarde mund të duken të largëta dhe jo realiste.

Për të kapërcyer hendekun e cilësisë, apo për të pasqyruar kushtet kulturore, ekonomike dhe kushtet e tjera që ndikojnë zbatimin, arritja e cilësisë së shërbimit të kujdesit social mund të planifikohet në përputhje me rrethanat, duke marrë parasysh nivelin e cilësisë së shërbimeve të administratës publike në përgjithësi dhe performancën e sistemit të kujdesit social në veçanti.

Në vazhdim, për arritjen e standardeve mund të aplikohen modele të ndryshme:

Arritja graduale e standardeve- standardet do të arrihen gradualisht brenda një afati kohor të rënë dakord, gjatë të cilit nuk do të sanksionohet mospërputhja e ofrimit të shërbimeve me standardin. Për ta udhëhequr këtë proces arritjeje graduale të standardeve, miratohet dhe monitorohet një afat kohor për arritjen e objektivave me hapa progresivë drejt përmbrushes së kërkesës për standardin.

- **Arritja e standardeve me përzgjedhje** - në rrethanat kur shërbimet zbatohen në situata ku risku për shëndetin fizik dhe mendor të përdoruesit të shërbimit peshon më shumë se mospërmbushja e SBC-ve nga shërbimi, disa standarde mund të përjashtohen përkohësisht nga vlerësimi, për të garantuar vazhdimesinë e shërbimit. Megjithatë, këtyre shërbimeve duhet t'u jepet prioritet, burime dhe një proces i rreptë monitorimi në mënyrë që të rinisë realizimi i SBC-ve aty ku shërbimi është në mospërputhje. Megjithatë, ky proces do të duhej të përkufizohej qartë për sa u përket përgjegjësive dhe procedurave për të përcaktuar nivelin e rrezikut.

Kombinimi i arritjes graduale dhe përzgjedhse të standardeve mund të jetë strategji për arritjen e standardeve kur praktikat aktuale janë larg standardeve bazë.

II. Standardet Bazë të Cilësisë për Shërbimet e Kujdesit Social

TEMAT	STANDARDET
TEMA 1: QEVERISJA DHE ZHVILLIMI I FUQISË PUNËTORE <p>Kjo temë mbulon SBC-të që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë dhe praktikat e menaxhimit për llogaridhjen, vendimmarjen dhe menaxhimin e riskut. Gjithashtu i përgjigjet planifikimit, rekrutimit, menaxhimit dhe organizimit të personelit me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për t'u përgjigjur nevojave të përdoruesve të shërbimit.</p>	STANDARDI 1. Qeverisja dhe menaxhimi i mirë STANDARDI 2. Zhvillimi i personelit dhe fuqisë punëtore STANDARDI 3. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit
TEMA 2: KUJDESI DHE MBËSHTETJA <p>Kjo temë mbulon SBC-të që kanë të bëjnë me kujdesin dhe mbështetjen që u jepet përdoruesve të shërbimit, për të dhënë rezultate më të mirë, për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të tyre, si dhe një cilësi të mirë jetese për përdoruesit e shërbimit, duke përdorur menaxhime të mirëzvilluara rastesh, planifikimin e kujdesit dhe mekanizmat e ankesave.</p>	STANDARDI 4. Mbrojtja e të drejtave të përdoruesve të shërbimit. STANDARDI 5. Sistemi i menaxhimit të rasteve dhe i planifikimit të kujdesit STANDARDI 6. Mbrojtja e të dhënavë dhe përdorimi i burimeve STANDARDI 7. Ankesat
TEMA 3: SHËNDETI, MIRËQENIA DHE SIGURIA <p>Kjo temë mbulon SBC-të që kanë të bëjnë me sigurimin e shëndetit dhe mirëqenies së përdoruesve të shërbimit, për të mbrojtur dhe promovuar mirëqenien e tyre dhe për të parandaluar dhe minimizuar dëmtimin e përdoruesve të shërbimit.</p>	STANDARDI 8. Ambienti dhe pajisjet fizike STANDARDI 9. Shëndeti dhe mirëqenia e përdoruesve të shërbimit STANDARDI 10. Aksidentet, emergjencat dhe krizat

TEMA 1:
QEVERISJA DHE ZHVILLIMI I FUQISË PUNËTORE

Kjo temë mbulon SBC-të që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë dhe praktikat e menaxhimit për llogaridhëni, vendimmarrjen dhe menaxhimin e riskut. Gjithashtu i përgjigjet planifikimit, rekrutimit, menaxhimit dhe organizimit të personelit me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të përdoruesve të shërbimit.

Standardi 1 Qeverisja dhe menaxhimi i mirë	Ofruesi i shërbimit ka krijuar rregullore të brendshme efikase për qeverisjen, menaxhimin dhe udhëheqjen, me linja të qarta llogaridhënieje për të ofruar kujdes dhe mbështetje të përqendruar te personi, të sigurtë dhe efektive.
Kriteret	Treguesit
<p>1.1. Ofruesi i shërbimit e menaxhon shërbimin sipas një metodologjie të mirëpërcaktuar të përshkruar në deklaratën e qëllimit.</p> <p>1.2. Ofruesi i shërbimit garanton që shërbimi t'i kryejë funksionet e veta ashtu si përshkruhen në ligjet, rregulloret, politikat kombëtare dhe standartet përkatëse për të mbrojtur dhe nxitur kujdesin dhe mirëqenien e çdo përdoruesi shërbimi.</p>	<p>Intervistat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofruesi i shërbimit mund të bëjë lidhje midis metodologjisë së përshkruar në deklaratën e qëllimit dhe ofrimit të shërbimit • Personeli e kuption modelin e kujdesit siç përshkruhet në deklaratën e qëllimit, kuption synimet e përgjithshme të shërbimit dhe rezultatet që kërkon të arrihen për përdoruesit. <p>Dokumentacioni</p> <ul style="list-style-type: none"> • Deklarata e qëllimit, si dhe vlerësimet dhe ndryshimet e saj të mundshme <p>Intervistat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofruesi i shërbimit mund të bëjë lidhje midis ofrimit të shërbimit dhe funksioneve specifike të përshkruara në ligjet, rregulloret, politikat dhe standartet kombëtare përkatëse • Personeli i ofruesit të shërbimeve shfaq mirëkuptim të ligjeve, rregulloreve, politikave dhe standardeve përkatëse për kujdesin dhe mirëqenien e përdoruesve të shërbimit, të përshtatshme sipas rolit të tyre <p>Dokumentacioni</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politikat dhe procedurat operative që janë zhvilluar dhe, rrjedhimisht, janë rishikuar dhe përditësuar nga ofruesi i shërbimit, që tregojnë përafrim me ligjet, rregulloret, politikat dhe standartet kombëtare

<p>1.3. Ofroesi i shërbimit bashkëpunon me të gjitha grupet e interesit të përfshira në politikëbërje, identifikim nevojash, planifikim, zhvillim, ofrim, monitorim dhe vlerësim shërbimesh, për të garantuar që shërbimi t'u përgjigjet nevojave të përdoruesve të shërbimit, si dhe nevojave lokale.</p>	<p>Intervistat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofroesi i shërbimit identifikon partneritetet dhe burimet kryesore në komunitet dhe kapacitetin e tyre për të ndërvepruar për përfitimin e shërbimit të ofruar • Ofroesi i shërbimit i përdor partneritetet e veta për ta pasuar ofertën e shërbimit të ofruar përdoruesve të shërbimit <p>Vëzhgim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Partnerët e jashtëm dhe grupet e interesit informohen për misionin kryesor, objektivat dhe grupet e shënjestruara të shërbimit. <p>Dokumentacioni</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lista e partnerëve (memorandume mirëkuptimi, kontrata) • Çdo dokumentacion që tregon se ofroesi i shërbimit ka pasur të bëjë me grupe të jashtme interesit të përfshira në hartimin e politikave, identifikimin e nevojave, planifikimin, zhvillimin, ofrimin, monitorimin dhe vlerësimin e shërbimit (procesverbalet e takimit, komunikimi, raportet, etj.) • Çdo dokumentacion që tregon se ofroesi i shërbimit ka ndërvepruar me komunitetin (p.sh. aktivitatet të shënjestruara komunikimi, pjesëmarrje në ditët e hapura, marrje me qira ambientesh, procesverbale takimesh, etj.)
<p>1.4. Ofroesi i shërbimit garanton struktura dhe rregullore të brendshme qartësisht të përkufizuara qeverisjeje që përcaktojnë linjat e autoritetit dhe përgjegjësisë, përfshirë dhe llogaridhëni individualë.</p>	<p>Intervistat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofroesi i shërbimit mund të përshkruajë rregulloret e brendshme dhe strukturat e qeverisjes, linjat e autoritetit dhe llogaridhëni • Ofroesi i shërbimit garanton që menaxherët të kenë kualifikimin e duhur, praktikë të mjaftueshme dhe përvojë menaxhimi për të menaxhuar shërbimin dhe për të përbushur deklaratën e qëllimit, synimet dhe objektivat e tij. • Personeli zbaton veprime që korrespondojnë me strukturën dhe rregulloret e brendshme të përcaktuara qeverisëse.



	<ul style="list-style-type: none">Personeli sigurohet që rregulloret e brendshme alternative të menaxhimit janë në fuqi kur mungon personi përgjegjës. <p>Vëzhgim</p> <ul style="list-style-type: none">Shërbimi ka një person të ngarkuar me llogaridhënien e përgjithshme ekzekutive, përgjegjësinë dhe autoritetin për ofrimin e shërbimit.Në të gjitha nivelet e shërbimit demonstrohet dhe dëshmohet udhëheqje dhe ekziston një kulturë të nxënë, cilësie dhe sigurie sipas politikës kombëtare dhe ligjeve përkatëse.Menaxhimi i shërbimit zbaton një qasje të bazuar te ekipi dhe promovohet nëpërmjet takimeve të rregullta të ekipit, të nxënët reflektues dhe komunikimit efektiv. <p>Dokumentacioni</p> <ul style="list-style-type: none">Çdo dokumentacion që dëshmon rregullore të brendshme dhe struktura të përkufizuara qeverisëse që përcaktojnë linjat e autoritetit dhe llogaridhënies, përcakton llogaridhënien individuale dhe specifikon role dhe përgjegjësi të gjithë personelit në shërbim (deklarata e qëllimit, rregullat dhe rregulloret e brendshme).Çdo dokumentacion që tregon se ka procedura të zyrtarizuara për rregulloret e gatshme të brendshme në mbrëmje dhe fundjavë, nëse është e nevojshme.Marrëveshjet e shërbimit, kontratat dhe rregulloret e tjera të brendshme që janë në fuqi për ofrimin e shërbimitKualifikimet e personelit menaxhues
1.5. Publiku është i informuar për shërbimin dhe mund aksesojë informacione lidhur me ofrimin e tij që mund ta lehtësojnë orientimin dhe mbulimin ndaj përdoruesve të mundshëm të shërbimit	<p>Vëzhgim</p> <ul style="list-style-type: none">Një grup informacionesh të përkufizuara për shërbimin, të përshtatura për publikun e gjerë, përfshirë dhe llojet, disponueshmërinë, shtrirjen dhe kufizimet e shërbimit të ofruar dhe të disponueshëm në ambiente, duke përfshirë një shumëllojshmëri metodash të përshtatura



dhe grupeve të tjera të interesit.	<p>komunikimi të aplikueshme sipas grupeve të ndryshme të shënjestruara</p> <p>Dokumentacioni</p> <ul style="list-style-type: none">Informacioni i përkufizuar, i shfaqur nëpërmjet një sërë mjetesh komunikimi (pamflete, fletëpalosje, faqe interneti, skeda informacioni, etj.), përfshirë metoda komunikimi të aksesueshme dhe të përshtatura të aplikueshme sipas grupit të shënjestruar
------------------------------------	--

TEMA 1:
QEVERISJA DHE ZHVILLIMI I FUQISË PUNËTORE

Kjo temë mbulon SBC-të që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë dhe praktikat e menaxhimit për llogaridhëni, vendimmarrjen dhe menaxhimin e riskut. Gjithashtu i përgjigjet planifikimit, rekrutimit, menaxhimit dhe organizimit të personelit me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të përdoruesve të shërbimit.

Standardi 2 Zhvillimi i personelit dhe fuqisë punëtore	<p>Shërbimi promovon shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e fuqisë punëtore me personel të mjaftueshëm të trajnuar dhe të kualifikuar që garanton cilësinë e ofrimit të kujdesit.</p>
Kriteret	<p>Treguesit</p> <p>2.1 Ofroesi i shërbimit bën shpërndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit që pasqyrohen te përshkrimet e punës dhe në organigramë</p> <p>Intervistat</p> <ul style="list-style-type: none"> Ofroesi i shërbimit mund të identifikojë rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të ndryshëm të personelit Përdoruesit e shërbimit, familjet e tyre ose përfaqësuesit e tyre ligjorë mund të identifikojnë anëtarët përkatës të personelit të përfshirë në ofrimin e shërbimit <p>Vëzhgime</p> <ul style="list-style-type: none"> Personeli po e kryen rolin e caktuar dhe merr përsipër përgjegjësitë përkatëse. <p>Dokumentacioni</p> <ul style="list-style-type: none"> Një organigramë me shpërndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit në përputhje me përshkrimet e punës Përshkrimet e punës të anëtarëve të ndryshëm të personelit
2.2 Ofroesi i shërbimit zbaton politika për burimet njerëzore, duke përfshirë profilet dhe kërkeshat e kualifikimit në përputhje me ligjet përkatëse.	<p>Intervistat</p> <ul style="list-style-type: none"> Ofroesi i shërbimit ka zhvilluar politika rekrutimi dhe mbajtjeje personeli në përputhje me ligjet dhe rregulloret e brendshme përkatëse. Ofroesi i shërbimit mund të arsyetojë në çdo kohë mjaftueshmërinë e numrit të duhur të personelit, me njohuritë, aftësitë, përvojën dhe kompetencat e nevojshme. Personeli mund të shpjegojë normat, procedurat dhe specifikat e detyrave të caktuara. Ofroesi i shërbimit zbaton rregullisht procedura vlerësimi performance.

	<p>Vëzhgime</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në krye të detyrës gjendet një numër i mjaftueshëm personeli në çdo kohë. <p>Dokumentacioni</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për gjithë personelin mbahen dosje të përditësuara, të sakta dhe të sigurta, në përputhje me kërkosat e rregulloreve të brendshme. • Kualifikimet e personelit • Në dosjet e personelit dokumentohen procedurat e vlerësimit të performancës.
